




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTRE SHTETI PËR
MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Raport i III
mbi trajtimin e ankesave dhe
sugjerimeve të sipërmarrjes
për muajin dhjetor 2017





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA MINISTRE SHTETI PËR MBROJTJEN E SIPËRMARRJES

Të nderuar miq sipërmarrës,

Në detyrën e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, në përmbushje të misionit të ndërmarrë për përmirësimin e klimës së biznesit në vend, lejomëni të ndaj me ju raportin e tretë të trajtimit të ankesave, në kuadër të njoftimeve periodike dhe raportimit mbi punën e kryer gjatë secilit muaj.

Përmes këtij dokumenti, në emër të transparencës ju raportojmë kërkesat dhe sugjerimet e ardhura nga ju gjatë muajit dhjetor si dhe zgjidhjen e ndërmarrë nga zyra jonë. Gjithsej kemi trajtuar 50 kërkesa, prej të cilave 29 kërkesë/ankesa, pas këshillimeve dhe gjetjes së hapësirave ligjore për të trajtuar çështjet, janë zgjidhur. Gjithashtu gjatë muajit dhjetor kemi publikuar dhe përmbledhjen e disa prej propozimeve tuaja, të botuara në një raport të mëvetësishëm.

Çdo propozim që na mbërrin nga grupet e ndryshme të interesit, sipërmarrësit, apo shoqatat, koordinohet me ministritë përkatëse të parashikuara për zgjidhjen specifike të secilës çështje, ndaj një pjesë e këtyre propozimeve janë në proces përpunimi dhe do të raportohen në vijim.

Duke besuar se marrëdhënia Qeveri-sipërmarrje ka hyrë tashmë në një fazë të re, atë të konkretësisë dhe bashkëpunimit të ndërsjellë, lutem konsiderojeni këtë dokument-raport si vullnet për komunikim intensiv, e sidomos si shteg përmes të cilit të drejtoni cdo shqetësim tuajin.

Mbetem me konsideratë,

Sonila Qato

Regjistri i ankesave të trajtuara

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.1	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	10.10.2017	Subjekti shoqëri kërkon ndalimin e firmave fallco që konkurrojnë veprimtarinë e tij.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.2	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	17.10.2017	Subjektet bënë kërkesë për ndalimin e piraterisë dixhitale në shërbimet kompjuterike.	Trajtuar me përgjigje në ndjekje.
Nr.3	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	22.11.2017	Opinion mbi thellimin e luftës kundër informalitetit	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.4	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	23.11.2017	Subjekti raporton mungesë informacioni mbi gjobitjen për punonjës të padeklaruar.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.5	Kryeministria	27.11.2017	Kërkohet përmirësim I VKM për Agjensinë e Prokurimeve Publike.	Në ndjekje.
Nr.6	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	28.11.2017	Problematikë rreth shitjes së kredive të provigjonuara. !	! Trajtuar me përgjigje.
Nr.7	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	4.12.2017	Rifillimi i procesit të privatizimit të tokave shtetërore nga Këshilli i Ministrave	Trajtuar me përgjigje.
Nr.8	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë !	! 4.12.2017	Subjekti kërkon zbatim të vendimit të formës së prerë në lidhje me pagesat në portin e Durrësit.	Trajtuar me përgjigje, në ndjekje.
Nr.9	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	5.12.2017	Subjekti kërkon rikontroll tatimor.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.10	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	7.12.2017	Subjekti raporton mos mbyllje në Q.K.R dhe një gjobë që duhet të ishte hequr nga sistemi tatimor.	Trajtuar me zgjidhje.

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.11	Bashkia Kuçovë	8.12.2017	Subjekti ka raportuar probleme në lidhje me një tender të fituar.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.12	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	11.12.2017	Subjekti kërkon rimbursimin e TVSH-së si fasoneri që në muajin qershor dhe pse ligji e parashikon brenda një afati 30 ditor.	Trajtuar me përgjigje në ndjekje deri në mbarim të procedurave.
Nr.13	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	12.12.2017	Subjekti raporton shqetësim në lidhje me udhëzimin nr.6 datë 30 janar 2015, për TVSH,neni 19.	Trajtuar me sqarimin përkatës.
Nr.14	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	12.12.2017	Subjekti kërkon leje për vënien në qarkullim të produkteve.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.15	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	13.12.2017	Subjekti raporton ankesë për gjobitje të padrejtë.	Trajtuar, në ndjekje.
Nr.16	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	13.12.2017	Subjekti kërkon sqarim të paketës fiskale në pikat e propozuara.	Trajtuar me përgjigje sqaruese.
Nr.17	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	13.12.2017	Subjekti kërkon rimbursim të TVSH-së kreditore.	Trajtuar, në ndjekje.
Nr.18	ZRPP	13.12.2017	Subjekti raporton problematika në regjistrim.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.19	ZRPP	15.12.2017	Subjekti raporton problematikë në regjistrim.	Trajtuar me zgjidhje.
Nr.20	Kryeministria	17.12.2017	Subjektit kërkon procedim administrativ nga APP.	Trajtuar, në ndjekje.
Nr.21	Ministria e Kulturës	19.11.2017	Subjekti kërkon zbatim të vendimit të gjykatës.	Trajtuar, në shqyrtim e sipër.

Nr.	Institucioni përgjegjës	Data	Tematika	Rezultati
Nr.22	Drejtoria e Përgjithshme Detare	20.12.2017	Subjekti raporton ankesë për rregulloren për përdorimin e detyrueshëm të rimorkiatorëve në Portin e Shëngjinit.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.23	ZRPP	22.12.2017	Subjekti raporton problematika në regjistrim.	Trajtuar, në ndjekje.
Nr.24	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	23.12.2017	Subjekti kërkon përmirësimin e çertifikimit të sistemeve të menaxhimit për zbatimin e standarteve UNI EN ISO.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.25	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	24.12.2017	Subjekti raporton problematika me lejen mjedisore.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.26	Bashkia Tiranë	25.12.2017	Subjekti raporton problematika në lidhje me rregullarizimin ligjor të ndërmarrjes.	Trajtuar me përgjigje.
Nr.27	Ministria e Kulturës	25.12.2017	Subjekti raporton mungesë informacioni sa i takon privatizimit të ndërmarrjes shtetërore.	Trajtuar me përgjigje shpjeguese.
Nr.28	Kryeministria	26.12.2017	Problematike në rialokimin e Fondeve për projektet e FZHR akorduar për Këshillat e Qarqeve.	Trajtuar, në ndjekje.
Nr.29	Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë	27.12.2017	Kërkesë për likuidimi të punimeve që kanë bërë firmat nënkontraktore të "Subjektit X" për një vepër publike. Subjekti X rezulton në faliment.	Trajtuar, në ndjekje.

